



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS

RREGULLORE
“PËR CAKTIMIN E SHPENZIMEVE PËR NDJEKJEN E PROCEDURAVE
PRANË AUTORITETIT TË KONKURENCËS”¹.

Në mbështetje të neneve 24, shkronja dh) dhe 84, shkronja b) të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

KOMISIONI I KONKURENCËS

VENDOSI:

Neni 1
Qëllimi

Kjo Rregullore ka për qëllim caktimin e tarifave të cilat paguhen nga ndërmarrjet pjesëmarrëse të përcaktuara në dispozitat e Ligjit nr.9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, në rastet e procedurave të kontrollit të përqendrimeve si dhe në rastet e procedurave të njoftimit për përjashtimin nga ndalimi të marrëveshjeve.

Neni 2
Fusha e Zbatimit

Kjo rregullore zbatohet nga Autoriteti i Konkurrencës me qëllim mbrojtjen e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg dhe në kuadër të përmbushjes së detyrimeve që përcaktojnë dispozitat e ligjit.

Neni 3
Përkufizime

1. “Ligji” nënkupton ligjin nr.9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar ;
2. “Autoriteti i Konkurrencës”, është struktura e ngarkuar me kontrollin e zbatimit të Ligjit nr.9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar;
3. “Komisioni i Konkurrencës” nënkupton strukturën vendimmarrëse të Autoritetit të Konkurrencës;
4. “Sekretariati i Konkurrencës” nënkupton strukturën zbatuese të institucionit.

¹ E ndryshuar me VKK nr. 778 datë 04.03.2021 “Mbi miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në rregulloren “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Neni 4

Caktimi i tarifave për ndjekjen e procedurave në rastet e kontrollit të përqendrimeve

(Përditësuar me VKK nr. 778 datë 04.03.2021)

1. Për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës, në rastet e kontrollit të përqendrimit, aplikohen tarifat e mëposhtme:
 - a) Njoftimi pranë Autoritetit të Konkurrencës nga ndërmarrjet pjesëmarrëse i një transaksioni, i cili nuk përmbush kriteret e përcaktuara në nenin 10 ose 12 të ligjit dhe për të cilin nuk kërkohet plotësimi i “Formularit të Njoftimit të Përqendrimit”, bëhet kundrejt pagesës me vlerë 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë.
 - b) Njoftimi pranë Autoritetit të Konkurrencës i “Formularit të Thjeshtuar të Njoftimit të Përqendrimit” nga ndërmarrjet pjesëmarrëse, sipas përcaktimit të nenit 10 dhe 12 të ligjit (që bashkohen, që përftojnë kontroll, për krijimin e një ndërmarrjeve të përbashkët si dhe për rastet kur pjesa e ndërmarrjes preket nga transaksioni i kryer) bëhet kundrejt pagesës me vlerë 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë.
 - c) Njoftimi pranë Autoritetit të Konkurrencës i “Formularit të Plotë të Njoftimit të Përqendrimit” nga ndërmarrjet pjesëmarrëse, sipas përcaktimit të nenit 10 dhe 12 të ligjit (që bashkohen, që përftojnë kontroll, për krijimin e një ndërmarrjeve të përbashkët si dhe për rastet kur pjesa e ndërmarrjes preket nga transaksioni i kryer) bëhet kundrejt pagesës me vlerë 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë.
2. Autorizimi “Për realizimin e përkohshëm të përqendrimit” i dhënë nga Komisioni i Konkurrencës, në bazë të kërkesës së ndërmarrje pjesëmarrëse, sipas përcaktimit të nenit 60, pika 1 e ligjit, “Autorizimi për përqendrimin e përkohshëm”, jepet kundrejt pagesës me vlerë 300.000 (treqind mijë) lekë
3. Autorizimi “Për realizimin e përqendrimit” i dhënë nga Komisioni i Konkurrencës, në përputhje me nenin 56 të ligjit “Procedura Paraprake”, jepet kundrejt pagesës me vlerë 500 000 (pesëqind mijë) lekë.
4. Autorizimi “Për realizimin e përqendrimit” i dhënë nga Komisioni i Konkurrencës në përputhje me nenin 57 të ligjit “Procedura e thelluar”, jepet kundrejt pagesës me vlerën që llogaritet :
 - a) në shumën prej 0.03% të xhiros së të gjitha ndërmarrjeve pjesëmarrëse së bashku, të vitit paraardhës financiar, që llogaritet sipas parashikimeve të neneve 15-17 të ligjit, në rastet kur plotësohen kushtet e parashikuara në nenin 12, pika 1, germa a) e ligjit, por në çdo rast pagesa nuk duhet të tejkalojë vlerën prej 2 000 000 (dy milionë) lekë; ose
 - b) në shumën prej 0.03% të xhiros së të gjitha ndërmarrjeve pjesëmarrëse së bashku, të vitit paraardhës financiar, që llogaritet sipas parashikimeve

të neneve 15-17 të ligjit, në rastet kur plotësohen kushtet e parashikuara në nenin 12, pika 1, germa b) e ligjit por në çdo rast pagesa nuk duhet të tejkalojë vlerën prej 2 000 000 (dy milionë) lekë.

5. Mos-klasifikimi si përqendrim i një transaksioni të caktuar, në rastet kur Komisioni i Konkurrencës shprehet me vendim, bëhet kundrejt pagesës me vlerë prej 150 000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë.

Neni 5

Caktimi i tarifave për ndjekjen e procedurave në rastet e njoftimit të marrëveshjeve që kërkojnë përjashtim nga ndalimi

1. Njoftimi nga ndërmarrjet i marrëveshjeve që kërkojnë përjashtimin nga ndalimi, sipas përcaktimit të nenit 5 dhe 49 të ligjit, bëhet kundrejt pagesës me vlerë 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë.
2. Vendimi për përjashtimin nga ndalimi, i dhënë nga Komisioni i Konkurrencës, sipas nenit 50 të ligjit, jepet kundrejt pagesës me vlerë 500 000 (pesëqind mijë) lekë.
3. Vendimi i dhënë nga Komisioni i Konkurrencës, për shtyrjen në kohë të përjashtimeve të marrëveshjeve të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, jepet kundrejt pagesës me vlerë 300.000 (treqind mijë) lekë.

Neni 6

Shërbime pa pagesë

1. Depozitimi dhe shqyrtimi i ankesave pranë Autoritetit të Konkurrencës, që kanë për objekt shkeljet e nenit 4 dhe 9 të ligjit është pa pagesë.
2. Dhënia e vlerësimeve dhe rekomandimeve nga Autoriteti, në përputhje me nenin 69 të ligjit, për çështje të lidhura me konkurrencën, me kërkesën e organeve të administratës qendrore dhe vendore, bëhet pa pagesë.

Neni 7

Kryerja e pagesave

1. Pagesat e parashikuara në nenin 4 dhe nenin 5 të kësaj rregulloreje do të bëhen në llogarinë bankare të Autoritetit, kundrejt Faturës për Arkëtim që lëshohet nga Autoriteti i Konkurrencës.
2. Të gjitha pagesat e parashikuara në këtë rregullore nuk janë të rimbursueshme, përfshirë edhe pagesën e kryer sipas parashikimeve të nenit 4, pika 1 të kësaj rregulloreje, në rastet kur një njoftim përqendrimi nuk klasifikohet si përqendrim pasi nuk përmbush kriteret e nenit 10 dhe 12 të ligjit.

Neni 8

Dispozita shfuqizuese

Rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”, miratuar me Vendimin nr.10, datë 29.06.2004 i ndryshuar të Komisionit të Konkurrencës, si dhe çdo dispozitë në rregulloret e mëparshme të Autoritetit të Konkurrencës, të cilat bien në kundërshtim me këtë rregullore, shfuqizohen.

Neni 9
Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi menjëherë